

KOMUNIKATË PËR MEDIA

Rebelizëm artistik në hapësirën publike

26 korrik 2014, Prizren

Në mbrëmjen e 25 korrikut 2014 (e premte) në Prizren u diskutua për artin publik dhe rolin e artistit si aktivist kulturor. Në forumin e diskutimit **"Artistët si aktivistë kulturor"** organizuar nga EC Ma Ndryshe, folës kryesor ishte artisti i njohur kosovar, **Sislej Xhafa**, i cili ndau përvojën e tij me intervenime në hapësirën publike. Pjesë e panelit ishin edhe dy fituesit e Thirrjes së fundit të EC Ma Ndryshe për intervenime artistike në Prizren, **Senat Haliti** dhe **Nora Temaj**, të cilët i ballafaquan idetë e tyre për intervenime me pjesëmarrësit e forumit.

Diskutimi në këtë forum u fokusua mbi potencialin e aktivizmit kulturor dhe urban në Prizren. Në veçanti u diskutua për potencialin e artistëve të Prizrenit për të vepruar si aktivistë kulturor në kohën kur struktura urbane dhe kujtesa kolektive e qytetit është duke u transformuar si rezultat i ndërhyrjeve të pakontrolluara. Si reagim, Sislej Xhafa sugjeroi rebelizëm artistik, përmes të cilit artisti duhet të realizojë veprën e i ntervenimit në hapësirë publike. Nora Temaj dhe Senat Haliti, në anën tjetër treguan se si intervenimet e tyre artistike do të protestojnë ndaj degradimit të qytetit. Një dimension i shumëtrajtuar i diskutimit ishte përfshirja e publikut në artin publik dhe raporti mes artistit, komunës dhe publikut.

Ky forum i diskutimit ishte konceptuar si organizim i përbashkët mes dy projekteve të EC Ma Ndryshe (Aktivizmi kulturor dhe urban, përkrahur nga Ambasada Amerikane dhe Qyteti Gjithëpërfshirës, përkrahur nga OPIC), të cilat bashkohen në synimin për të nxitur veprimin e komunitetit artistik në hapësirën publike të Prizrenit. Projekti "Aktivizmi kulturor dhe urban në Prizren" është një nismë e intervenimit kulturor dhe artistik që synon t'i trajtojë në mënyrë kreative sfidat e zhvillimit urban dhe reformës demokratike në Prizren. Në anën tjetër, "Qyteti gjithëpërfshirës" është projekt tre-vjeçar i EC Ma Ndryshe, i cili synon të artikulojë nevojat e grupeve të komunitetit dhe t'i përkthejë ato në plane të zbatueshme urbane të komunës së Prizrenit.

Me respekt,
Hajrulla Çeku, drejtor ekzekutiv
OJQ EC Ma Ndryshe

"Projekti Aktivizmi kulturor dhe urban në Prizren u financua përmes grantit të Ambasadës Amerikane në Prishtinë. Mendimet, përfundimet dhe konkludimet apo rekomandimet e shprehura këtu janë të Autorit(ëve) dhe jo medoemos pasqyrojnë qëndrimet e Departamentit të Shtetit."

Projekti "Qyteti gjithëpërfshirës – planifikimi me pjesëmarrje për zhvillim të qëndrueshëm urban në Prizren" përkrahet financiarisht nga Olof Palme International Center, që përkrahet nga Qeveria e Suedisë

